

## **STATUTI**

### **SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

#### **“M-E Construction Company” Sh.P.K.**

Në këtë statut

-“Ligji” është Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;

- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

#### **Kreu I**

##### **Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

##### **Neni 1:Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më 01.06.2021, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “M-E Construction Company” Sh.P.K

(2)Themelimi ishoqërisë është bere nga;

>Zoti Mariglen Mullaj, i biri Xhevahirit, i datelindjes 23.08.1983, banues neRrugen Qemal Stafa, Xhafzotaj, Durres, Shqiperi, me shtetesi Shqiptare, me karte identiteti nr.034403677

>Zoti Ermal Mullaj, i biri Xhevahirit, i datelindjes 07.07.1985, banues ne Lagjen nr.10, Rruga Eleni Dasho, Durres, Shqiperi, me shtetesi Shqiptare, me karte identiteti nr.037253963

##### **Neni 2:Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin; “Investime dhe Sherbime ne ndertim, punime strukturash beton arme, rifiniture, etj.”

##### **Neni 3:Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë mbi 10 vjet.

##### **Neni 4:Selia**

(1)Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Lagja nr.10, Rruga Eleni Dasho, Zona kadastrale8512,nr.pasurie 19/640/ND, Durres.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon; ermalmullaj01@gmail.com, Telefon kontakti; 069 4556440

## **Kreu II**

### **Kapitali**

#### **Neni 5: Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin eshoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku Mariglen Mullaj zoteron 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 leke, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku Ermal Mullaj zoteron 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 leke, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut është në para.

#### **Neni 6: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7: Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**  
**Neni 8: Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdondryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve pershoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" tekësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga njëortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqerisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë epërgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cilapërfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**Neni 9: Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e pergjithshme thirret nepërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohetnga statuti, me njoftim nepërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazhelektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohettë gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen easamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrëvendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10: Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicëtë kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 11: Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e raporteve financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim i statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyruar ndryshimet në skedën shoqërisë.

### **Neni 12: Përjashtimi nga e drejta e votes**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendimpër:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13: Administrimi**

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratori shoqërisë caktohet, Zoti Mariglen Mullaj, i biri Xhevahirit, i datelindjes 23.08.1983, banues ne Rrugen Qemal Stafa, Xhafzotaj, Durres, Shqiperi, me shtetesi Shqiptare, me karte identiteti nr.034403677

### **Neni 14: Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë në mënyrë vajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërret Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:



-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qëaktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerëmë të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare tëcertifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortakpasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnëbashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë tëzakonshme.Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënievekontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 15: Përgjegjësia e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkeljetë ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohenadministratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individualeosolidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipaseneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare“, administrator detyrohet:

- 1.a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë sëshoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, tëinteresave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2.Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprimose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, mepërrjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse,veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me takanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kurshkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit përgabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV**

#### **Viti financiar-ekspertet**

#### **Neni 16: Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 17: Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim pernxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike tëushtuara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

## **Kreu V**

### **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

#### **Neni 18: Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për QendrënKombëtare të Biznesit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper“.Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen eafhtësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pasprishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 19: Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme tëAsamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX tëLigjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

#### **Neni 20: Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat elegjislacionit shqiptar.



Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dheshoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.


### **Neni 21: Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te lindre midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetekompetente Gjykata Perkatese.

### **O R T A K E T**

### **ESHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**(Mariglen Mullaj )**



**( Ermal Mullaj )**

